



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 15

Datë: 13. 05. 2019. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 14 /2019
- 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 3. Certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan,**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut.**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve më datën 19 maj 2019,**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Vendimit për pagesat e KVV-ve dhe Stafit Teknik për Qendrat e Votimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan.**
- 7. Të ndryshme.**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E kemi kuorumin për mbajtjen e mbledhjes. A ka dikush vërejtje lidhur me rendin e ditës, propozime...?

Unë, kam një vërejtje: Ka kaluar një javë nga koha kur krye shefi, është dashur të na e sjellë planin e tij të punës...Po ia kujtoj...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Si dhe miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr. 14 /2019.

Enis Halimi: Sekretariati ka vazhduar me përmbushjen e aktiviteteve dhe realizimit të proceseve të këtyre zgjedhjeve. Periudha për votim jashtë Kosovës, ka filluar më 11 maj, dhe numri i pakove që janë dërguar është 274 pako për komunën e Leposaviqit, 80 pako për Zubin Potok, 65 pako për Zveqan, dhe 378 pako për Mitrovicën e veriut. Periudha për votim më votim me nevoja të veçanta, së pari është bërë njoftimi i tyre përmes KKZ-ve, konform rregullave ne u jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për të na dhënë informacione për të burgosurit që janë në këto komuna, dhe për të sëmurit që janë qendrat klinike. Kemi pranuar të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, dhe rezulton që janë 12 të burgosur, dhe nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka të hospitalizuar.

Procesi i trajnimit është në përmbyllje e sipër, dhe materialet e tjera teknike, trajnuese dhe të tjera janë përfunduar, si dhe informimi publik po ecën në rrjedhën e tij, si dhe jemi në proces të përmbylljes së materialeve tenderuese...I keni informacionet...

2.Certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan.

Valdete Daka: Sipas dokumenteve që kemi, Lista Përfundimtare përmban: 57983 votues, me një diferencë prej 970 votues më shumë në krahasim me zgjedhjet lokale 2017. I keni edhe shënimet tjera adekuate përcjellëse..

A ka ndonjë pyetje, sugjerim...?

Florian Dushi: Praktisht, tabelat e dhëna në fq. 9, lidhet me ndarjen dhe totalin nëpër komuna...Pra, janë njësi të veçanta zgjedhore...

Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, certifikuan Listën Përfundimtare të Votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut.

Enis Halimi: Kjo është një praktikë e KQZ-së, kemi përgatitur numrin dhe që kjo është në kuadër të funksionit ligjor...

Valdete Daka: Sipas draft vendimit, numri total që do të shtypet, është : 53250. Kurse, numri i fletëvotimeve rezervë që shtypen kalkullohet duke u rrumbullakuar me kufirin e poshtëm, deri në plotësim të dengut me 50 fletëvotime, me numrin prej 3% të votuesve për çdo komunë...! Një fjali që, vështirë kuptohet...

Sami Hamiti: Kush e ka bërë këtë vendim...?

(Shpjegime lidhur me këtë vërejtje, dhanë Enis Halimi, Kreshnik Spahiu, Florian Dushi...)

Valdete Daka: Të formulohet fjalia, periudha...s'ka logjikë kjo...teksti...! Ri formulohet...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan numrin e Fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve më datën 19 maj 2019

Enis Halimi: Ky është një plan që përcjellë secilin proces zgjedhor. Parashihen disa bartës së procesit në funksion të zbatimit të ditës zgjedhore, është dokument i zakonshëm, standard...Dhe, ju lusim ta miratoni...

Vadete Daka: Po konferencat a janë planifikuar, ku do të mbahen konferencat për shtyp...? Bashkangjiteni edhe orarin e konferencave...

Florian Dushi: Plani operacional me këto aktivitete, është gjithëpërfshirës por, po më duket se po mungon komunikimi dhe bashkëpunimi me OSBE-në... Këtu në plan nuk ka asgjë lidhur me kontaktet dhe koordinimin me OSBE-në, që edhe duhet ta kemi...

Nazlie Bala: Këtij plani, i mungon edhe aspekti i informimit. Nuk ka rëndësi se në sa komuna bëhen zgjedhjet...Marrja dhe dhënia e informacioneve, është tejet me rëndësi...Konferencat duhet të mbahen...Po ashtu, pajtohem edhe me mendimin e Florianit, por besoj se edhe OSBE ka një plan të vetin, dhe mendoj që duhet të diskutojmë konkretisht me OSBE-në sa i parkete realizimit të planeve operacionale...Pra, duhet të harmonizohet bashkëpunimi...

Enis Halimi: Sigurisht, ne do ta inkorporojmë edhe planin e konferencave, dhe sa i parkete OSBE-së, ata do të jenë në dhomën operative...

Florian Dushi: Unë po flas për linja zyrtare të komunikimit. Tash jemi në një nivel kur ne po bashkëpunojmë dhe ky nivel është i matshëm, sidomos në pjesën ku mbahen zgjedhjet

dhe, ne duhet të jemi të informuar në linjën mes dy misionëve, dhe jo vetëm përmes një a dy zyrtarëve...

Valdete Daka: Të përfshihen këto vërejtje...

Nazlie Bala: Ne, nuk e dimë ende se cili është plani i OSBE-së...! Unë, nuk po e shoh të arsyeshme që...Unë mendoj që duhet të bashkëpunojmë..

Kush është për...duke shtuar propozimet në plan...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan Planin Operacional për ditën e zgjedhjeve.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Vendimit për pagesat e KVV-ve dhe Stafit Teknik për Qendrat e Votimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan.

Enis Halimi: Ky është një vendim që u paraprinë pagesave të stafit jo permanent...Shumat kanë qenë të planifikuara, është vendim që është në përputhje me projektimet tona buxhetore...Dhe ne, rekomandojmë që ky draft të votohet nga ju...

Valdete Daka: A janë këto çmime si në zgjedhjet e kaluara...?

Enis Halimi: Po, asnjë ndryshim nuk ka nga zgjedhjet e kaluara...

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan draft Vendimin për pagesat e KVV-ve dhe Stafit Teknik për Qendrat e Votimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan.